



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA DIBER

(DREJTORIA E PERFORMANCES, STATISTIKAVE DHE IDEVE TE ZHVILLIMIT)

**INFORMACION PERMBLEDHES MBI RAPORTIN E PERFORMANCES SE BASHKISE DIBER PER
VITIN 2024**

PER:

Keshillin Bashkiak Diber

Date 22.12.2025

Sistemi i Matjes së Performancës

Është mekanizmi kombëtar dhe vendor për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi ofrimin e shërbimeve nga bashkitë. Ky sistem përfshin një grup treguesish dhe nën-treguesish të standardizuar, që përdoren për të krahasuar performancën e bashkive, për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në evidencë.

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 33, çdo bashki është e detyruar të krijojë një sistem të brendshëm matjeje dhe raportimi mbi performancën e saj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, përdorimin e burimeve dhe realizimin e objektivave. Ky sistem vendor lidhet ngushtë me sistemin kombëtar, duke mundësuar harmonizimin e të dhënave dhe krahasimin mes njësive të vetëqeverisjes vendore.

Bazuar në këtë sistem, janë mbledhur treguesit dhe është hartuar raporti i treguesve të performancës për vitin 2024. Këta tregues janë dërguar në Agjencinë Për Mbeshtetjen e Vetëqeverisjes Vendore (APMVV) me shkresën nr.2920 prot, datë 31.07.2025. Treguesit janë dërguar sipas platformës perkatese dhe në kohën e duhur. Për shkak të gjykimit të treguesve si pozitiv e në përmirësim e sipër, mbi bazën e matricës vlerësuese, bashkise i është akorduar grant në masën 14,100,000 leke, duke u renditur në 10 bashkitë fituese në shkallë vendi.

Bazuar edhe në kërkesën e Agjencisë, i paraqesim Keshillit Bashkiak për informim, informacionin përmbledhës të treguesve të performancës.

Raporti i Performancës për vitin 2024 synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi performancën e bashkisë në 11 fusha funksionale. Ky raport përdoret për të ndihmuar vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien, si dhe për të mundësuar krahasimin ndërmjet bashkive në nivel kombëtar.

Ky raport është përgatitur nga Bashkia Diber, i mandatuar nga Kryetari i Bashkisë në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, Neni 33, si dhe në kuadër të Sistemit Kombëtar të Matjes së Performancës (SMP 2025), dhe po i parqitet keshillit bashkiak për informim e në mënyrë të përbledhur si më poshtë:

1.Arsimi parauniversitar

Në përgjithësi, vitin 2024 e karakterizon një trend pozitiv në arsimin parauniversitar. Shkalla e regjistrimit në çerdhe publike është ulur. Shkalla e regjistrimit në kopshte publike ka një rënie të lehtë nga vjetor gjithsesi mbetet me e lartë. Analiza e nën-treguesve nxjerr në pah diferenca të dukshme gjinore.

2.Menaxhimi i Mbetjeve

Gjatë viteve 2023–2024, bashkia ka përmirësuar shërbimet të menaxhimit të mbetjeve. Mbulimi i popullsisë me këtë shërbim është rritur ndjeshëm – nga 37% në gati 50% – duke përfshirë më shumë zona rurale dhe urbane në sistemin e rregullt të pastrimit. Kjo tregon për një përpjekje të qëndrueshme për ta bërë territorin më të pastër dhe për të ofruar një shërbim më të mirë për qytetarët. Edhe sasia e mbetjeve të mbledhura është rritur me rreth 12%, çka tregon se sistemi po funksionon më mirë dhe po përfshin në ofrimin e shërbimeve më shumë banorë.

*Megjithatë, **sfi**da kryesore mbetet ajo financiare. Të ardhurat nga tarifa e shërbimit janë shumë të ulëta krahasuar me koston e ofrimit të tij.*

3.Mbrojtja nga zjarret

Gjatë viteve 2023–2024, mbrojtja nga zjarri në bashki ka mbetur në një nivel të qëndrueshëm, por me disa sfida që kërkojnë vëmendje. Të dhënat tregojnë se numri i punonjësve ka rënë nga 19 në 18, **ndërsa** numri i mjeteve zjarrëfikëse ka mbetur i pandryshuar, me gjithsej 3 mjete funksionale.

Konkretisht, treguesi “punonjes për 1,500 banorë” prej 0.38. Në të njëjtën kohë, treguesi “Automjete zjarrëfikëse për 10,000 banorë” ka mbetur në nivelin 0.40 – pra, pa ndryshim, por gjithsesi pa përmirësim. Bashkitë janë përgjegjëse për operimin e njësive zjarrëfikëse, parandalimin e zjarreve dhe edukimin e komunitetit. Të dhënat e 2023-2024 tregojnë një situatë të qëndrueshme në infrastrukturë, por me sfida në kapacitetin njerëzor.

***Sfi**da: Kapacitet i kufizuar njerëzor, nevoja për trajnime dhe ndërhyrje më të shpejtë në emergjencë.*

4.Menaxhimi i Infrastrukturas së Ujitjes dhe Kullimit

Për periudhën 2023–2024 është vërejtur një përmirësim i dukshëm në infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit të tokave bujqësore. Sipërfaqja e pajisur me kanale ujitjeje dhe kullimi është rritur ndjeshëm,

duke treguar investime dhe kujdes më të madh për menaxhimin e ujit. Përqindja e kanaleve funksionale është rritur gjithashtu, çka tregon përmirësim të efikasitetit dhe shfrytëzimit të sistemit ekzistues.

Megjithatë, kanalet ujitëse mbeten në të njëjtin nivel funksionaliteti, çka sugjeron nevojën për më shumë mirëmbajtje dhe ndërhyrje teknike. Në përgjithësi, të gjithë treguesit janë pozitivë, duke reflektuar ecuri të mirë dhe përmirësim të qëndrueshëm në menaxhimin e tokave bujqësore

5.Administrimi I Pyjeve dhe Kullotave

Në përgjithësi, menaxhimi i fondit pyjor dhe kullor ka mbajtur një nivel stabil me një përmirësim të vogël në mbulimin njerëzor për njësi hektari, por ka mungesë të avancimit në përgatitjen dhe zbatimin e planeve të mbarështimit. Për të përmirësuar performancën e përgjithshme, është e domosdoshme të intensifikohet implementimi i planeve mbarështimore dhe të rritet kapaciteti planifikues në mënyrë që të sigurohet zhvillim i qëndrueshëm i fondit pyjor dhe kullor. ***Sfide** mbetet hartimi i planeve të menaxhimit dhe zhvillimi i qendrueshëm.*

6.Mbrojtja Sociale

Treguesit tregojnë se përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike mbetet e lartë , pavarësisht uljes krahasuar me vitin e kaluar.

Shkalla e miratimit të strehimit social ka një rënie minimale (-0.09%), ndërsa numri i qendrave sociale për 10,000 banorë mbetet i pandryshuar (0.4).

Përqindja e rasteve të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit dhe personat me aftësi të kufizuara që marrin mbështetje është 100%.

Plani Vendor Social u miratua për herë të parë gjatë periudhës raportuese.

Sfidat kryesore përfshijnë:

Rënia e përqindjes së grave të referuara që përfitojnë shërbime sociale (-33%).

Numer i ulët i qendrave sociale rezidenciale dhe mbulimi i ulët i qendrave ditore.

Disa grupmosha nuk raportohen plotësisht për shërbimet e marra, duke krijuar boshllëqe në mbështetje.

7.Burimet Njerezore

Në përgjithësi, bashkia ka avancuar në zhvillimin e kapaciteteve të stafit dhe rritjen e efektivitetit administrativ, por ka ende nevojë për fokus më të madh në trajnime.

8.Transparenca

Nga këndvështrimi i performancës, të gjithë treguesit mbeten në nivel të njësuar. Ky rezultat tregon nevojën për një fokus më të madh në realizimin praktik të konsultimeve publike, duke synuar **rritjen e pjesëmarrjes** dhe përmbushjen e të gjitha akteve të detyrueshme, në mënyrë që të arrihet një nivel më i lartë transparence dhe përfshirjeje qytetare.

9.Barazia Gjimore

Rezultatet pozitive vërehen te rritja e përqindjes së grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të larta, të mesme dhe të ulëta), e cila është rritur me rreth 45% krahasuar me vitin e kaluar. Kjo tregon se më shumë gra po marrin përgjegjësi menaxheriale dhe po përfshihen në drejtimin e strukturave të administratës lokale — një hap i rëndësishëm drejt barazisë.

Pavarësisht rritjes së pjesëmarrjes në nivelet e mesme, gratë ende hasin vështirësi për të arritur në nivelet më të larta drejtuese.

Inkurajues është fakti i miratimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjimore gjatë vitit 2024, që tregon vullnet institucional për të avancuar politikën gjimore dhe për të forcuar pjesëmarrjen e grave në jetën publike.

Në përfundim, duhet të ***mbahet stabiliteti i përqindjes së grave në pozicionet drejtuese.***

10.Integrimi në BE

Raporti tregon një performancë të kufizuar të bashkise në proceset e integrimit evropian. Nga pesë tregues të vlerësuar, vetëm një ka shënuar përmirësim — projektet e fituara nga BE, që janë rritur nga 0% në 33.3%. Treguesit e tjerë, si marrëveshjet ndërbashkiake, strukturat e performancës, planet e migracionit dhe komisionet e integrimit, mbeten pa ndryshim.

Sfida: Nevojitet forcim i strukturave të brendshme dhe rritje e kapaciteteve për të përthithur më shumë fonde dhe për të avancuar në procesin e integrimit evropian

11.Menaxhimi financiar

Në vitin 2024, shpenzimet totale të bashkisë u ulën me rreth 3.6% krahasuar me 2023. Shpenzimet kapitale kanë rënë ndjeshëm (-23%), ndërsa shpenzimet e personelit dhe operacionale u rritën lehtësisht (13% dhe 1%). Pësha e investimeve në buxhet dhe detyrimet e papaguara kanë rënë, duke treguar një fokus më të madh tek menaxhimi i likuiditetit dhe stabiliteti financiar. Situata tregon disiplinë buxhetore të përmirësuar.

12.Te ardhurat

Kjo fushë vlerëson kapacitetin e bashkisë për të gjeneruar të ardhura të qëndrueshme dhe diversifikuara përmes burimeve të veta dhe atyre të transferuara. Analiza e të ardhurave kontribuon në kuptimin e varësisë nga transfertat qendrore dhe fuqisë fiskale lokale. E drejta e njësive të vetëqeverisjes vendore për të mbledhur të ardhura buron nga neni 11 i Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e veta

Per Bashkinë Diber gjatë vitit 2024 të ardhurat janë 2,270,412,000 lek.

13.Shpenzimet

Kjo fushë analizon strukturën dhe efikasitetin e shpenzimeve publike të bashkive për të përmbushur funksionet e tyre ligjore. Ajo vlerëson nëse fondet shpenzohen në mënyrë të efektshme dhe transparente. Bashkitë janë përgjegjëse për planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve publike vendore, në përputhje me nenin 12 dhe 13 të Ligjit nr. 68/2017 dhe aktet nënligjore përkatëse

Per kete periudhe jane shpenzuar 2,270,412,000 lek.

PERFUNDIME E REKOMANDIME

Bashkia Dibrë ka shënuar një ecuri të qëndrueshme zhvillimi, duke reflektuar përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e shërbimeve publike dhe jetesës së qytetarëve. Përmasat e territorit, pasuritë natyrore dhe potenciali bujqësor e turistik e vendosin Dibrën përballë mundësive të rëndësishme zhvilluese, por edhe kërkesës për planifikim më të kujdesshëm e investime afatgjata.

Në fushën e arsimit, bashkia ka bërë hapa të dukshëm përpara: infrastruktura e institucioneve arsimore është përmirësuar, kushtet për fëmijët janë bërë më të mira dhe numri i stafit është rritur. Këto ndryshime tregojnë angazhimin për të garantuar një mjedis më të sigurt dhe më cilësor për fëmijët. Megjithatë, mbeten ende sfida që lidhen me barazinë gjinore në pjesëmarrje dhe nevojën për të balancuar cilësinë mes arsimit publik dhe privat.

Edhe në **menaxhimin e mbetjeve**, Dibra ka bërë progres duke rritur mbulimin e territorit dhe sasinë e mbetjeve të mbledhura. Ky është një hap i rëndësishëm drejt një mjedisi më të pastër për komunitetin. Përballja me kostot e larta të shërbimit mbetet sfida kryesore, duke kërkuar zgjidhje të qëndrueshme financiare. Ndërkohë, shërbimi zjarrfikës ka mbetur në nivele të qëndrueshme, por kapacitetet aktuale nuk janë të mjaftueshme për një territor kaq të gjerë, çka nënkupton nevojën për përforcim të burimeve njerëzore dhe logjistike.

Sektori i bujqësisë ka përfituar nga investimet në kanalet e ujitjes dhe kullimit, duke treguar rritje të funksionalitetit të sistemit dhe përmirësimin e kushteve të punës për fermerët. Edhe fondi pyjor dhe kullësor është menaxhuar në mënyrë stabile, por *kërkohet ritëm më i lartë në zbatimin e planeve mbarështimore për të garantuar qëndrueshmërinë e burimeve natyrore.*

Në aspektin social, Dibra paraqet një situatë ku shërbimet për personat me aftësi të kufizuara dhe mekanizmat e referimit funksionojnë mirë, numri shumë i lartë i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe mungesa e qendrave sociale tregojnë nevojën për politika më të thelluara sociale dhe ekonomike. Pozitive mbetet miratimi i Planit Vendor Social dhe rritja e rolit të grave në vendimmarrje, e cila tregon vullnet për të avancuar barazinë gjinore dhe përfshirjen.

Për sa i përket **integritimit evropian**, performanca ka qenë e kufizuar, me përmirësime vetëm në sigurimin e projekteve të financuara nga BE. *Kjo sinjalizon domosdoshmërinë për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe për një angazhim më madh në proceset e integritimit.*

Nga ana financiare, bashkia ka treguar disiplinë më të mirë, duke ulur shpenzimet totale dhe detyrimet e papaguara. Rënia e shpenzimeve kapitale, megjithëse një tregues i kujdesit buxhetor, evidenton nevojën për më shumë investime në zhvillimin e infrastrukturës.

Në përfundim, Bashkia Dibër ka bërë përparime të rëndësishme, veçanërisht në fushat e arsimit, bujqësisë dhe barazisë gjinore dhe investimeve. Megjithatë, sfida të tilla si përfshirja sociale, menaxhimi i mbeturinave, shërbimet emergjente dhe aftësia për të tërhequr fonde zhvilluese mbeten prioritet të rëndësishme.

Konceptoi:

Pergjegjesi i Sektorit te Performances

Nevila Manga



PER DREJTORINE E PERFORMANCES,

STATISTIKAVE DHE IDEVE TE ZHVILLIMIT

Drejtori

Dali Horeshka

